



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 106/02-1160/19
Kaçanik, 14.01.2019

Në bazë të nenit 70 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.04/2011 për procedurat disiplinore, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit disiplinor të SH.C.K-së

1. Me këtë vendim formohet Komisioni Disiplinor për zhvillimin e procedurës disiplinore dhe marrjen masave në rastet që kanë të bëjnë, me shkelje të rënda të Ligjit të Shërbimit civil apo të akteve nënligjore.
2. Komisioni duhet të jetë i përbërë prej tre antarëve, të cilët do të kenë mandate dy vjeçar me mundësi vazhdimi dhe do të pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.
3. **Komisioni disiplinor ka këtë përbërje:**
 1. Menduh Krasniqi- Kryetar i komisionit
 2. Mirlinda Dema-anëtar i komisionit
 3. Murat Burrniku - anëtar i komisionit .
4. Komisioni do ta kryej funksionin në pajtim të nenit 70 dhe 71 të Ligjit për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe rregulloren Nr.04/2011 për procedurat disiplinore në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Njësia e personelit
- Arkivi komunal



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



I	Data	24.01.19	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/01-2305	✓		

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale; nenit 2 pika 1.8 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për Parandalimin dhe Ndalimin e Formave të Rrezikshme të Punës së Fëmijëve, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Kaçanikut, me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje, Kryetari i Komunës, merrë këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE

- I. Me këtë vendim Themelohet Komiteti Lokal i Veprimit për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve;
- II. Komiteti Lokal i Veprimit ndërmerr masa për parandalimin, identifikimin, tërheqjen dhe mbrojtjen e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda dhe të rrezikshme;
- III. Komiteti Lokal i Veprimit në bazë të të dhënave për fëmijët e identifikuar në punë të rënda, harton plane komunale për koordinimin e aktiviteteve ndërinstitutionale të nivelit lokal për mbrojtjen e kësaj kategorie;
- IV. Të gjitha rastet e identifikuar do të trajtohen nga tryeza për menaxhimin e rasteve;
- V. Komiteti bën vlerësimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale ekzistuese në nivelin lokal dhe përmes rekomandimeve dhe udhëzimeve i propozon kryetarit të komunës për mbështetje të nevojshme;
- VI. Komiteti Lokal i Veprimit për PEPF themelohet në bazë të termave të referencës për PEPF të miratuara nga Kryetari i Komunës;
- VII. Anëtarët e Komitetit Lokal të Veprimit janë zyrtarë të lartë të autoriteteve lokale, përfaqësues të partnerëve social dhe të shoqërisë civile;
- VIII. Komiteti si në pikën I të këtij vendimi përbëhet nga përfaqësuesit në vijim:
 - 1) z. Xhelal Gashi nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale;
 - 2) z. Gafurr Guri nga Drejtoria për Arsim dhe Kulturë;
 - 3) z. Mustafë Loku nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;

- 4) z. Beqir Krasniqi nga Qendra për Punë Sociale;
- 5) z. Ibrahim Tërstena nga Njësia për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave;
- 6) z. Shyqeri Trena nga Policia e Kosovës;
- 7) znj. Valbona Dema nga Policia e Kosovës - Njësia Kundër Dhunës në Familje;
- 8) z. Mehmet Mulaku nga Zyra e Punësimit;
- 9) znj. Elmi hane Krasniqi nga OJQ-të;
- 10) znj. Ardiana Tusha nga Këshilli i Veprimit Rinor;
- 11) z. Jashar Selimi nga Asambleja Komunale e Fëmijëve.

IX. Udhëheqës i Komiteti Lokal të Veprimit për PEPF është përfaqësuesi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

X. Komiteti Lokal i Veprimit harton raportin mbi situatën e punës së fëmijëve bazuar në raportet e partnerëve në nivelin lokal për komunën e Kaçanikut i cili raport përfshinë: të dhëna statistikore, analizën e të dhënave, vlerësimin dhe rekomandimet për Kryetarin e Komunës.

XI. Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- 1 Anëtarët e KLV-së;
- 2 MPMS/DPSF;
- 3 Kabineti i Kryetarit të Komunës;
- 4 Arkivi i Komunës.

Kryetari i Komunës,

z. Besim Ilazi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



01.Nr 104/07-2267/19
Kačanik, 24/01/2019

Në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

**PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT ORGANIZATIV KOMUNAL PËR
KREMTIMIN E "17 SHKURTIT"- FESTA E SHPALLJES TË PAVARËSISË SË
KOSOVËS**

1. Me këtë vendim themelohet këshilli organizativ komunal për kremtimin e "17 shkurtit"- festa e shpalljes të pavarësisë së Kosovës, me anëtarët si në vijim:
 1. Ylber Bajra - koordinator i këshillit;
 2. Izahir Doda - anëtar;
 3. Fatmir Qaka - anëtar;
 4. Fatlume Selimi - anëtare;
 5. Hajrulla Shehu - anëtar;
 6. Ismajl Murseli - anëtar;
 7. Fatos Vishi - anëtar;
 8. Remzije Dardhishta - anëtare;
 9. Ruzhdi Gjini - anëtar, dhe
 10. Muharrem Ahmetaj - anëtar.
2. Përbërja e këtij këshilli është bërë në formën që të ketë gjithëpërfshirje të të gjithë akterëve të cilët mund të kontribuojnë në kremtimin e përvjetorit.
3. Detyrat kryesore të këshillit janë që të organizojnë takime dhe të përzgjedhin formën më të mirë të shënimit të kësaj dite shumë të rëndësishme, përfshirë programin artistik, organizimin, orarin, ftesat, çështjet teknike, sportin etj.
4. Mandati i këshillit si në pikën 1. të këtij vendimi, përfundon me rastin e shënimit të kësaj dite, gjegjësisht më 19/02/2019.
5. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit të tij.

I dërgohet:

Anëtarëve

Arkivit


Kryetari i Komunës

z. Besim Hazi





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik
Zyra e Kryetarit



01.Nr. 104/02-2312/19
Kačanik, 24/01/2019

Kryetari i Komunës së Kaçanikut në bazë të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6, pika b dhe h, të Statutit të Komunës së Kaçanikut,

Propozon

Që Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12. të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 8 pika 3. e Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e datës _____ mori këtë:

VENDIM

PËR PLOTËSIMI-NDRYSHIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim plotësohet-ndryshohet komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe rrjedhimisht plotësohet pika 1.6 e vendimit me nr. të protokollit 01Nr. 104/02-8499/18, të datës 30/03/2018,
2. Hiqet nga komisioni anëtari z. Zylfi Koxha, dhe zëvendësohet me anëtarin z. Besnik Bajra.
3. Ky vendim bëhet i plotfuqishëm me rastin e nënshkrimit të tij.

Arsyetim

Më datë 23/10/2018, anëtari dhe njëherit kryesuesi i zgjedhur i komisionit të lartpërmendur ka kërkuar me shkrim që të lirohet nga komisioni në fjalë. Në këtë kërkesë, janë dhënë arsyet se për shkak se i lartpërmenduri nuk mund të japë kontributin e duhur në fushën juridike sepse konsideron që në aspektin juridik ndien mangësi në të kuptuarit të ligjeve dhe akteve nënligjore sidomos në interpretimin e tyre. Ne, duke parë rëndësinë që ka ky komision, e kemi aprovuar kërkesën dhe njëherësh kemi propozuar që të zëvendësohet me anëtarin e ri- Besnik Bajra. Bazuar në situatën e krijuar kërkojmë nga anëtarët e Kuvendit Komunal, që të shqyrtojnë dhe të miratojnë këtë plotësim-ndryshim të komisionit.

Kryetari i Komunës
Z. Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 104/p2-2432 /19

Kaçanik, 25.01.2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Ligjit Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e zyrtarit përgjegjës për Qasje në dokumente publike

1. **znj. Fatlume Guri**, Zyrtare për informim dhe monitorim të mediave, caktohet si zyrtar përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente zyrtare apo zyrtar përgjegjës për komunikim me qytetar, detyrë këtë të përshkruar edhe në vendin e saj të punës Zyrtar për informim dhe monitorim të mediave.
2. Detyrat dhe përgjegjësit konkrete të këtij zyrtari janë të përcaktuara në Ligjin për qasje në dokumente publike
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

Arsyetim

Sipas Ligjit për qasje në dokumente publike të gjitha institucionet publike janë të obliguara të caktojnë njësinë apo zyrtarin të cilët janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente. Prandaj, duke pasur parasysh zbatimin e këtij Ligji dhe përshkrimin e vendit të punës Zyrtar për informim dhe monitorim të mediave në të cilin është e përshkruar një detyrë e tillë, u vendos që Zyrtarja në fjalë të caktohet si zyrtare përgjegjëse për qasje në dokumente publike.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, Kryetari i Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë vendim të njoftohen ;

- z.Fatlume Guri
- Njësia e personelit

